**MARREVESHJE PER BLERJEN ME KUSHT TE PJESEVE TE KAPITALIT-PLANI 2015**

MIDIS

Ortakut dhe Administratorit të Shoqërisë Facilization SHPK

**Gjergji Guri**

Dhe Punonjësit të Shoqërisë Facilization SHPK

**Sokol Kreshpa**

Datë, 1-Nëntor-2016

**MARREVESHJE PER BLERJEN PJESEVE TE KAPITALIT**

MIDIS:

- Z. Gjergji Guri, i biri i Anestit, lindur më 9/6/1975 në Korcë dhe banues në Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisë,(më poshtë i quajtur " **Ortaku**");

Dhe

- Z. Sokol Kreshpa, i biri i Hairiut, lindur më 15/03/1989 në Vlorë dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I90315135H, Punonjës i shoqërisë Facilization SHPK, (më poshtë i quajtur " Pjesëmarrësi");

Të gjithë palët e përmëndura më sipër, të gjithë së bashku do të quhen "Palët".

PLANI I SHITJEVE TE KUOTAVE ME KUSHT 2015

**Qëllimi**
Qëllimi i këtij Plani është që të promovojë objektivat e shoqërise Facilization shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria") duke ju ofruar punonjësve të dalluar stimuj për të maksimizuar vlerën e Shoqërisë dhe vazhdimësinë e punësimit në të. Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me gërma kapitale të përdorura në këtë dokument janë të përcaktuara në nenin 4.

**Administrimi**
Plani do të administrohet nga Gjergji Guri (më poshtë quajtur "Ortaku") që do të ketë autoritet të plotë dhe liri të pakushtëzuar për të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron të nevojshëm për administrimin dhe funksionimin e Planit.Ortaku nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, i jep Pjesëmarrësit të drejtën që të blejë prej tij pjese që ai zotëron në kapitalin e Shoqërise, sipas kushteve të parashikuara më poshtë.

**Kuotat e Vlefshme në Plan**

I. **Kuota Bazë**. Ortaku zotëronte me datë 30 Dhjetor 2015, 4.750 kuota të kapitalit, të Shoqërisë Facilization Shpk të cilat në bazë të Ligjit Nr. 129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, konvertohet në 1 kuotë, me vlerë 4.750.000,00 Lekë e cila perfaqëson 95% te kapitalit të regjistruar i cili ka vlerën 5.000.000 LEKE. Përqindja totale e kuotës në pronësi të tij që Ortaku vë në dispozicion të punojësve të Shoqërisë në favor të këtij Plani nuk duhet t'i tejkalojë shtatëmbëdhjetë përqind (17%) të kapitalit të Shoqërisë. Përqindja e kapitalit e vlefshme për blerje me kusht (Opsione) do u jepet punojësve të Shoqërisë që përmbushin kushtet e vëna nga Ortaku.

II. **Kuota Shtesë.** Në rastin e skadencës së Opsioneve të dhëna, anullimit ose kur një Opsion ka përfunduar, pjesët e vëna në dispozicion deri në atë moment, të cilat nuk janë blerë nga Pjesëmarrësi, do të kthehen përsëri në dispozicion për qëllimin e Planit.

**DUKE PATUR PARASYSH PLANIN E SIPERPERMENDUR, PALET BIEN DAKORT SI VIJON:**

NENI 1
PERKUFIZIME TE PERGJITHSHME

a. Termat e përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e përshkruar më poshtë nëse nuk është parashikuar ndryshe apo nëse nuk kanë kuptim tjetër sipas kontekstit të përdorimit.

b. Patransferueshmëria. Asnjë Opsion nuk mund të transferohet, ose premtohet nga Pjesëmarrësi te një i tretë gjatë jetës së tij. Në varësi të kufizimeve të përfshira në këtë nen, një opsion mund të blihet gjatë jetës së Pjesëmarrësit vetëm nga Pjesëmarrësi. Kjo e drejtë nuk do të jetë e transferueshme dhe duhet të ushtrohet vetëm nga punonjësit të cilit i është dhënë kjo e drejtë. Pjeset e lëshuara pas blerjes të një opsioni mund t'u nënshtrohen kufizimeve të tilla siç janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë apo në këtë Marrëveshje.

c. Angazhime paraprake. Si kusht për blerjen e pjeseve në pajtim me kufizimet e një Opsioni, Punonjësi angazhohet nëçdo kohë të përfundojë çdo marrëveshje që kërkohet nga Ortaku apo Administratori i Shoqërisë për të përmbushur detyrimet e nevojshme ligjore apo fiskale që mund të lindin në lidhje me transaksionine shitblerjes së pjeseve.

d. Kufizime të të Drejtave. Asgjë në këtë marrëveshje nuk i jep Pjesëmarrësit ndonjë të drejtë për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit për një periudhë të caktuar apo ta ndërpresë atë sikundër nuk kufizon të drejtat e Shoqërisë të ndërpresë marrëdhëniet e punës të Pjesëmarrësit në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, me apo pa shkak.

e. Pjesëmarrësi nuk ka të drejtë t'i shesë, dhurojë, apo të transferojë në çdo mënyrë tjetër tek të tretët, apo t'i lerë peng apo ngarkojë me çfarëdo lloj barre, pjesërisht apo tërësisht pjesët që zotëron në kapitalin e Shoqërisë të fituara si pasojë e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

NENI 2
OPSIONET

a. **Opsionet**. Opsionet përfaqësojne një pjesë të kapitalit të Shoqërisë te shprehur në përqindje të kapitalit të shlyer të shoqërise dhe të cilat janë subjekt i Planit të Shites së Kuotave me Kusht të përcaktuar dhe evidentuara nga "**Njoftimi i Blerjes me Kusht**" të kësaj marrëveshjeje për të cilat Pjesëmarrësi gëzon të drejtën e blerjes më kusht. Këto Opsione do t'i nënshtrohen dhe do të jenë subjekt i kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshjeje.

b. **Masa e Kontibutit** (pjesë e kapitalit). Njoftimi i Blerjes me Kusht do të specifikojë masën e kontributit në përqindje të kapitalit që është subjekt i blerjes me kusht.

c. **Çmimi i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A specifikon çmimin e blerjes së Opsioneve i cili nuk mund të jetë më pak se njëqind për qind (100%) të vlerës së tregut të një kuote në përpjestim me kontributin përkatës të shprehur në përqindje të kapitalit në datën e nënshkrimit të marrëvëshjes. Çmimi i blerjes për çdo opsion të ofruar sipas këtij Plani do të përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga Ortaku Gjergji Guri sipas gjykimit të tij. Çmimi i ofruar duhet të jetë i pagueshem në një formë të përshkruar në Nenin 3.

d. **Kushtëzimi**. Opsionet do të kthehen në pjesë kapitali të bleshme (përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët (e), (f) dhe (g) më poshtë) në pjesë kumulative prej njëzet përqind (20%) te pjesës totale qe përfiton Pjesmarrësi, në fund të çdo viti të periudhës së kushtëzimit sic parashikohet në Shtojcën A.

e. **Blerja**. Opsionet duhet të blihen në datën e specifikuar në Njoftimin e Blerjes me Kusht; me kusht që, sidoqoftë, nëse një ngjarje anullimi ndodh para përfundimit të periudhës së kushtëzimit, e drejta për të ushtruar Opsionet anullohet dhe e drejta e

disponimit të opsionit i mbetet Ortakut i cili mund t'i disponojë ato sipas gjykimit dhe vullnetit të tij të lirë.

f. **Afati i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A, specifikon kufizimet në afate për blerjen e kuotave të ofruara në këtë plan që nuk mund të kalojë datën **30 Dhjetor 2023**, me përjashtim të rastit kur Ortaku përcakton një afat tjetër. Me përfundimin e Afatit të Blerjes, Pjesëmarrësi humbet të drejtën për të blerë opsionet e vlefshme të kapitalit të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërise.

g. **Ndërprerja e marrëdhenieve të punës**. Në rast se gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, Pjesëmarrësi largohet nga Shoqëria apo atij i ndërpritet kontrata e punës nga Punëdhënësi për cdo loj arsyeje, të gjitha Opsionet e akumuluara ndër vite por të pablera ende, do të anullohen menjëherë.

h. **Data e Blerjes**. Data e blerjes është data në të cilën Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes është dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku.

i. **Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes**. Është njoftimi i dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku sipas parashikimeve të nenit 5.1, në të cilin duhet të caktohen të paktën:
   a. Masa e kontributit në kapital të Ortakut që do t'i ofrohen për shitje Pjesëmarrësit;
   b. Datën e Zbatimit.

j. **Data e Zbatimit**. Është data e përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes për pagesën e çmimit për transferimin e pjesëve të shitura në këtë datë.

k. **Vendi i Zbatimit**. Është në Tiranë, Shqipëri, siç përcaktohet në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes që do të jete vendi në të cilin Pjesëmarrësi do t'i paguajë Ortakut Çmimin e Shitjes së Pjesëve.

l. **E drejta e votës.** Deri në vërtetim të blerjes së pjesëve të ofruara kundrejt Çmimit të Blerjes, Pjesëmarrësi nuk gëzon të drejtën e votës si dhe asnjë të drejtë tjetër që mund të ushtrohet nga ortakët e shoqërisë në bazë të ligjit apo statutit të shoqërisë.

m. **Plotësimi i Kushtit të blerjes**: nënkupton përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

   a. Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes ushtruar nga Pjesmarrësi e nënshkruar rregullisht nga të dy palët dhe pasi jane plotësuar kushtet e parashikuara në këtë kontratë.
   b. Pagesa e cmimit të blerjes së përcaktuar nga Ortaku në, ose para datës së zbatimit sipas mënyrës së specifikuar ne këtë kontratë.

NENI 3
E DREJTA E BLERJES

a. Blerja e kuotave të lëshuara në bazë të kesaj marrëveshjeje do të paguhet me transfertë bankare duke kredituar llogarinë e Ortakut.

b. Nëse Pjesëmarrësi vendos të ushtrojë të Drejtën e Blerjes duke ushtruar Opsionin, blerja kushtëzohet vetëm mbi Pjesët që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërisë që janë objekt i kësaj marrëveshjeje sipas Çmimit të Blerjes së Pjeseve të Ortakut të përcaktuara në Noftimin e Blerjes me Kusht.

NENI 4
PËRCAKTIME

a) “Shoqëri” do të thotë shoqëria Facilization Shpk, e regjistruar sipas ligjeve Shqiptare, me seli në: " Rr . Barrikadave, P. 118, Ap . 15, 1001, Tiranë, Shqipëri, që vepron nën kodin NIPT : K94702003N.

b) "Ngjarje Anullimi" do të thotë (i) vdekja apo paaftësia, ose (ii) një ndryshim në kontrollin e Shoqërisë.

c) "Çmimi i Blerjes" do të thotë shuma për të cilën mund të blihet një pjese e kapitalit kur ushtohet Opsioni, siç është përcaktuar nga kjo marrëveshje në Njoftimin e Blerjes me Kusht nga Plani 2015.

d) “Vlera e Tregut " nënkupton vlerën e tregut të një pjese të kapitalit, siç përcaktohet nga Ortaku në mirëbesim. Përcaktim i tillë do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjithë punonjësit/pjesmarresit.

e) "Njoftimi i Blerjes me Kusht" do të thotë një njoftim në formën e bashkangjitur si Shtojca A e Marrëveshjes Për Blerjen me Kusht të Pjesëve të Kapitalit sipas Planit 2015 që evidenton dhënien e një mundësise për Punojësin nga Ortaku.

f) "Opsion" do të thotë alternativa për blerjen me kusht të nje pjese të kapitalit nën këtë kontratë qe i jep të drejtën mbajtësit për të blerë kuota kapitali të cilat janë subjekt i Planit të Shitjes së Kuotave me Kusht.

g) "Pjesëmarrës" nënkupton një punonjës të Shoqerisë të cilit Ortaku i ka ofruar, dhe që punonjësie ka pranuar, të drejtën për të blerë kuota sipas Planit 2015.

h) "Plan" do të thotë Plani i Shitjes së Kuotave me Kusht të Shoqërisë nga Ortaku.

i) “Kushtëzim Periudhe" do të thotë periudha katër (4) vjeçare duke filluar nga Data e Marrëveshjes gjatë të cilës Opsionet duhet të piqen duke u shndërruar në pjesë të barabarta prej njëzet përqind (20 %) në fund të çdo viti

NENI 5
ZBATIMI

5.1 Pjesëmarrësi ka të drejtë që, në çdo moment gjatë Afatit të Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, nëpërmjet dorëzimit të Njoftimit të Ushtrimit të së Drejtes së Blerjes Ortakut, të blejë pjesët e ofruara, kundrejt Çmimit të Blerjes. Me ushtrimin e kësaj të drejte nga ana e Pjesëmarrësit, ai do të jetë i detyruar të blejë Pjesët e ofruara kundrejt pagimit të Çmimit të Blerjes.

5.2 Shitja e Pjesëve do të perfshijë edhe të drejtën mbi çdo divident të deklaruar, por akoma të pa marrë nga Ortaku në lidhje me këto pjesë për përjudhën që fillon që nga data e kalimit të pronësisë tek Pjesmarrësi.

5.3 Pjesëmarrësi do të blejë në Datën dhe Vendin e Zbatimit Pjesët e Ortakut te përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, dhe do t’i paguajë Ortakut Çmimin e Blerjes në fonde menjëhere të përdorshme në monedhën e përcaktuar nga Ortaku.Ortaku do t’i dorëzojë Pjesëmarrësit dokumentet përkatëse të nënshkruara për transferimin e Pjesëve të lira nga çdo barrë.

NENI 6
DEKLARIME DHE GARANCI

6.1 Ortaku deklaron dhe garanton se Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar rregullisht dhe që ekziston sipas legjislacionit të Shqipërisë, është rregullisht e licencuar dhe zotëron leje dhe licenca të rregullta dhe në fuqi, të cilat

janë të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht. Ortaku gëzon zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe autoritet të plotë për të zotëruar dhe disponuar pronat e saj dhe të zhvillojë aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht.

6.2 Ortaku deklaron dhe garanton se gëzon zotësi të plotë juridike për të lidhur dhe zbatuar këte Marrëveshje dhe të transferojë pjesërisht apo tërësisht pjesët e kapitalit mbi të cilat Pjesëmarrësi mund të ushtrojë të Drejtën e Blerjes dhe këto pjesë janë të lira nga barra, kufizime apo të drejta të tjera të të tretëve mbi to.

NENI 7
TE NDRYSHME

7.1 Kjo Marrëveshje mund të shtohet apo ndryshohet vetëm nëpermjet një akti me shkrim dhe të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Pjesëmarrësi nuk mund t'i kalojë të tretëve, një pjesë apo të gjitha të drejtat që rrjedhin për të nga kjo Marrëveshje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ortakut.

7.3 Në rast se një ose disa nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të shfuqizohet, do të bëhet e pavlefshme apo e paekzekutueshme për shkak të parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj apo ligjeve që mund të hyjnë në fuqi gjatë kohëzgjatjes së saj, ajo klauzole do të veçohet dhe kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe ekzekutohet sikur klauzola e pavlefshme të mos ishte asnjëherë pjesë e Marrëveshjes dhe nenet e tjera të saj do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen aspak nga klauzola e pavlefshme, e shfuqizuar ose e paekzekutueshme ose nga veçimi i saj nga Marrëveshja.

7.4 Çdo njoftim apo komunikim sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet nëpërmjet (i) postës rekomande me pergjigje të marrësit në adresen e palës së cilës i behet njoftimi, (ii) postës ekspres, ose (iii) duke ia dorëzuar dorazi personit ose me postë elektronike (e-mail). Njoftimi do të konsiderohet i marrë në datën në të cilën është dorëzuar dorazi ose ditën e dytë të punës pas ditës së nisjes me postë ekspres. Nëse njoftimi dërgohet me poste rekomande, ai do të konsiderohet se është marrë diten e tretë të punës nga data në të cilën është postuar. Për qëllim njoftimi, adresat e palëve do të jenë ato që tregohen në fillimin e kësaj Marrëveshjeje.

7.5 Kjo Marrëveshje dhe të drejtat e detyrimet e palëve do të rregullohen, interpretohen dhe ekzekutohen në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet paraprakisht nga palët me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NE PRANI TE NJERI TJETRIT, palët nënshkruajnë këtë Marreveshje në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjte secila, sot më date 14/07/2016.

Nga:

Gjergji Guri

________________

Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë Gjergji Guri

Nga:

Eshal Krespa

________________

Pjesëmarrësi
Emër Mbiemër Nënshkrim

**Shtojca A**

**NJOFTIMI I BLERJES ME KUSHT - Plani 2015**

**Emri i Blerësit:** Sokol Kreshpa

**Pjesa e kapitalit:** 1,6% e kapitalit te Shoqërise Facilization Sh.p.k. i detajuar në Grafikun e Kushteve te Blerjes si më poshtë

**Çmimi i Blerjes:** 400,000 (Katërqind mijë) LEK

**Data e Marreveshjes:** 1 Nëntor 2016

**Data e Blerjes:** E drejta e blerjes mund të zbatohet si e plotë apo në pjesë për perqindjen e kapitalit qe është pjesë e kësaj marrëveshjeje në përputhje me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje duke filluar nga data e nënshkrimit të Njoftimit të Blerjes me Kusht

**Grafiku i Kushteve të Blerjes:** Opsionet do të maturohen për të qenë kuota të bleshme të kapitalit në përputhje me kushtet dhe termat e përcaktuara në seksionin 2 (d) të Marrëveshjes sipas grafikut më poshtë:

| Data | Përqindje e vlefshme për Blerje |
|---|---|
| **14-07-2016** | 0,32 |
| **14-07-2017** | 0,64 |
| **14-07-2018** | 0,96 |
| **14-07-2019** | 1,28 |
| **14-07-2020** | 1,6 |
| **30-12-2023** | 1,6 |

**Data e Skadencës:** Në varësi të përfundimit të mëhershëm , në përputhje me nenin 2 (g) të Marrëveshjes, Opsioni dhe e drejta e blerjes së kuotave të kapitalit do të përfundojë më **30 Dhjetor 2023**.

**BLERESI/Pjesëmarrësi:**

Sokol Kreshpa

**Emër Mbiemër Nënshkrimi**

**Datë:** 1-11-2016

**SHITESI/ Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë:**

**Emër Mbiemër Nënshkrimi**

**Datë:** 1-11-2016



# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot, më **01-Nëntor-2018** është nënshkruar kjo Kontratë shitblerje kuotash (këtu e më poshtë referuar si "**Kontrata**") midis palëve të mëposhtme:

- Z. **Gjergji GURI**, i biri i Anestit, lindur më 9.6.1975 në Korçë dhe banues në Rr. Faik Konica, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisëFacilization SHPK,(më poshtë i quajtur " **Shitësi**");

*Dhe*

- Z. **Sokol Kreshpa**, ibiriiHairiut, lindur më 15.03.1989 në Vlorë dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I90315135H, Punëmarrësi shoqërisë Facilization SHPK,(më poshtë i quajtur "**Bleresi**");

Shitësi dhe Bleresi të cilët referohen bashkërisht si '**Palët**" dhe individualisht si "**Pala**".

NDERSA:

I. Në bazë të Vendimit të Ortakëve të shoqërisë**Facilization SHPK** me date 14-dhjetor-2015, një shoqëri e themeluar dheregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Shqipëri më2 Nëntor 2009,me seli nëRr. Sami Frashëri, P. 56, Kompleksi TID, Hyrja B, Kati 1, Tiranë, me numër unik të identifikimit të subjektit K94702003N me kapital të regjistruar prej 5.000.000,00 lekë, ortakët të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë**Facilization SHPK,** kanë vendosur të lejojnë ortakun Gjergji Guri i cili është zotërues i një kuote e cila përfaqësonte në atë moment 95% të kapitalit të Shoqërisë të ofrojë për shitje një pjesë të përqindjes që zotëron në kapitalin e shoqërisë në sasinë jo më shumë se 17% të kapitalit dhe kohën dhe mënyrën e caktuar prej ortakut Gjergji Guri nëpërmjet marrëveshjeve që ky i fundit do të nënshkruajë me bleresin/t potencial/ë sipas vullnetit dhe gjykimit të tij të lirë.

II. Bazuar në sa më sipër si dhe nëbazë tëMarrëveshjes së opsionit datë 1 Nëntor 2016 të nënshkruar midis ortakut Gjergji Guri dhe Sokol Kreshpa, ky i fundit ka dorëzuar më datë 26 tetor 2018 Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes sipas parashikimeve tëMarrëveshjes së opsionit të cituar në këtë nen.

**ATEHERE**, palët bien dakord sa më poshtë:

**Neni 1**
**Objekti**

1.1 Shitësi bie dakord t'i shesë Bleresit dhe Bleresi bie dakord të blejë nga Shitësi 1 (një) kuotë të zotëruar prej këtij të fundit në kapitalin e Shoqërisë, e cila përfaqëson 0.32% (zero pike tridhjetë e dypër qind) të kapitalit të Shoqërisë me vlere nominale 16,000 Leke (gjashtëmbëdhjetë mije leke), të lirë nga çdo peng ("**Kuota**").

**Neni 2**
**Çmimi i kuotës dhe mënyra e pagesës**

2.1 Çmimi që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për blerjen e Kuotës do të jetë 80.000,00 (tetëdhjetë mijë Leke) dhe do të paguhet sipas nenit 3 më poshtë.

**Neni 3**
**Transferimi i kuotës**

3.1 Të drejtat pronësisë të Shitësit mbi Kuotën e Shoqërisë do t'i transferohen Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën e çmimit prej 80.000,00 Leke (tetëdhjetë mijë Leke) në llogarinë bankare të Shitësit sipas të dhënave të mëposhtme:
Gjergji Guri, Banka Kombëtare Tregëtare - DEGA PIAZZA, Numër Llogarie LEK : 402328893, IBAN: AL87205113203288893CLIDCLALLG

3.2. Transferimi i kuotës do të ndodhë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën shumesprej 80.000,00 (tetëdhjetë mijë Leke) tëçmimit të shitblerjes.

3.3. Pas transferimit të pjesës së mësipërme të kapitalit Blerësi do të zotërojë 1 (Një) kuote e cila përbën 0.96% (zero pikë nëntëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale 48,000 (dyzete e tetë mijë lekë), ndërsa Shitësit i mbetet një kuote e cila përfaqëson 89.1%( tetëdhjetë e nëntë pikë një përqind)

3.4 Palët janë në dijeni dhe bien shprehimisht dakord që Blerësi nuk ka të drejta dhe pretendime mbi fitimet e pa shpërndara teshoqërisë të cilat mund të shpërndahen si dividend i aplikueshëm mbi kuotën objekt i kësaj kontrate shitje, për vitin financiar i cili përfundoi më 31 dhjetor 2017 apo vitet e tjerë paraardhes.Blerësi fiton të drejtën mbi fitimet e shoqërisë të realizuara gjatë vitit aktual i cili përfundon në 31 dhjetor 2018, dhe gjithmonë në raport me kuotën që zotëron në shoqëri si dhe në proporcion me periudhën e fitimit të kësaj kuote.

**Neni 4**
**Përfaqësime dhe garanci**

4.1 Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Shitësi përfaqëson dhe i garanton Blerësit se:

i. Shitësi ështëzotëruesi i ligjshëm i 89.42% (tetëdhjetë e nëntë pikë dyzetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë sëKuotës, të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt material mbi të drejtën e pronësisë sëKuotës.

ii. Shitësi nuk po shkel ndonjë marrëveshje në të cilën paraqitet si palë, e cila mund të ndikojë negativisht në blerjen e Kuotës;

iii. Kuota nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi apo barre në favor të ndonjë palë të tretë.

4.2 Shitësi përfaqëson dhe garanton se ka aftësinë ligjore të nënshkruajë këtëkontratë dhe të gjitha kushtet dhe afatet të kësaj kontratë janë të detyrueshme për tu zbatuar prej tij.

4.3 Asnjë konflikt/përputhshmëria me ligjin e aplikueshëm: Nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate, përfundimi i Mbylljes si dhe çdo dokument tjetër dhe transaksion i parashikuar këtu, nuk përbën konflikt me, nuk rezulton në shkelje me apo të përbëjë shkelje nën: a) çdo ligj, rregullore, gjykimi, urdhër, dekret, urdhër ose vendim i ndonjë gjykate, autoritet apo arbitrit në fuqi ose që kanë juridiksion mbi Shitësin; apo b) ndonjë shoqëri apo dispozitë kontraktuale me

të cilin Shitësi është i detyruar as ndonjë marrëveshje tjetër ose instrument të cilin Shitësi është palë.

4.4. Shitësi ka të drejta të plota ligjore mbi pronësinë e Kuotës dhe ka të drejtën e plotë dhe kompetencën për të shitur, caktuar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

**Neni 5**
**Taksat e aplikueshme**

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhen sipas ligjit.

**Neni 6**
**Të ndryshme**

6.1 Kjo Kontratësë bashku me Marrëveshjen e opsionit datë1-Nëntor-2016përbëjnë marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklarim, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis palëve që nuk është përfshirë në këtëKontratë dhe në Marrëveshjen e opsionit që mund tëkenë pasojë ose efekt mbi Kontratën ose objektin e saj.

6.2 Kjo Kontratë nuk do tëndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojëKontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të dyja palët.

6.3Nëse ndonjë nga nenet e Kontratësshpallete pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

6.4 Blerësi nuk do transferojë Kontratën dhe/ose të drejtat dhe detyrimet përkatëse sipas kësaj Kontrate, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit.

6.5 Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera midis palëve kontraktore do të bëhen në formë të shkruar dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen nëpërmjet postës së regjistruar ose elektronike në adresën e mëposhtme:

**Z. Gjergji Guri**

Posta: Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë
Posta Elektronike: gjguri@gmail.com

**Z. Sokol Kreshpa**

Posta: Rr.Zef Jubani, Pallati Merkaj, Ap7, Kati 2 Tirana, Albania
Posta Elektronike: sokolkreshpa@gmail.com

6.6Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësishtë kundër njërës Palë në krahasim me Palën që ka përgatitur të njëjtën gjë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Kontrate.

6.7 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.8Kontrata hartohet dhe nënshkruhet në3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, një kopje për shitësin, një për bleresin dhe një për regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

**Për shitësin** **Për bleresin**

**Gergji GURI** **Sokol Kreshpa**

# MARREVESHJE PER BLERJEN ME KUSHT TE PJESEVE TE KAPITALIT-PLANI 2015

---

MIDIS

Ortakut dhe Administratorit të Shoqërisë Facilization SHPK
**Gjergji Guri**

Dhe Punonjësit të Shoqërisë Facilization SHPK
**Olti Qirici**

Datë, 14-Korrik-2016

---

**MARREVESHJE PER BLERJEN PJESEVE TE KAPITALIT**

MIDIS:

- Z. Gjergji Guri, i biri i Anestit, lindur më 9/6/1975 në Korcë dhe banues në Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisë,(më poshtë i quajtur " **Ortaku**");

Dhe

- Z. Olti Qirici, i biri i Pavllos, lindur më 25.06.1985 në Tiranë dhe banues në Rr. Ali Pashe Gucia, P.69/1, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I50625134L, Punonjës i shoqërisë Facilization SHPK, (më poshtë i quajtur " **Pjesëmarrësi**");

Të gjithë palët e përmëndura më sipër, të gjithë së bashku do të quhen "Palët".

PLANI I SHITJEVE TE KUOTAVE ME KUSHT 2015

**Qëllimi**
Qëllimi i këtij Plani është që të promovojë objektivat e shoqërise Facilization shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria") duke ju ofruar punonjësve të dalluar stimuj për të maksimizuar vlerën e Shoqërisë dhe vazhdimësinë e punësimit në të. Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me gërma kapitale të përdorura në këtë dokument janë të përcaktuara në nenin 4.

**Administrimi**
Plani do të administrohet nga Gjergji Guri (më poshtë quajtur "Ortaku") që do të ketë autoritet të plotë dhe liri të pakushtëzuar për të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron të nevojshëm për administrimin dhe funksionimin e Planit.Ortaku nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, i jep Pjesëmarrësit të drejtën që të blejë prej tij pjese që ai zotëron në kapitalin e Shoqërise, sipas kushteve të parashikuara më poshtë.

**Kuotat e Vlefshme në Plan**

I. **Kuota Bazë**. Ortaku zotëronte me datë 30 Dhjetor 2015, 4.750 kuota të kapitalit, të Shoqërisë Facilization Shpk të cilat në bazë të Ligjit Nr. 129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, konvertohet në 1 kuotë, me vlerë 4.750.000,00 Lekë e cila perfaqëson 95% te kapitalit të regjistruar i cili ka vlerën 5.000.000 LEKE. Përqindja totale e kuotës në pronësi të tij që Ortaku vë në dispozicion të punojësve të Shoqërisë në favor të këtij Plani nuk duhet t'i tejkalojë shtatëmbëdhjetë përqind (17%) të kapitalit të Shoqërisë. Përqindja e kapitalit e vlefshme për blerje me kusht (Opsione) do u jepet punojësve të Shoqërisë që përmbushin kushtet e vëna nga Ortaku.

II. **Kuota Shtesë.** Në rastin e skadencës së Opsioneve të dhëna, anullimit ose kur një Opsion ka përfunduar, pjesët e vëna në dispozicion deri në atë moment, të cilat nuk janë blerë nga Pjesëmarrësi, do të kthehen përsëri në dispozicion për qëllimin e Planit.

**DUKE PATUR PARASYSH PLANIN E SIPERPERMENDUR, PALET BIEN DAKORT SI VIJON:**

NENI 1
PERKUFIZIME TE PERGJITHSHME

a. Termat e përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e përshkruar më poshtë nëse nuk është parashikuar ndryshe apo nëse nuk kanë kuptim tjetër sipas kontekstit të përdorimit.

b. Patransferueshmëria. Asnjë Opsion nuk mund të transferohet, ose premtohet nga Pjesëmarrësi te një i tretë gjatë jetës së tij. Në varësi të kufizimeve të përfshira në këtë nen, një opsion mund të blihet gjatë jetës së Pjesëmarrësit vetëm nga Pjesëmarrësi. Kjo e drejtë nuk do të jetë e transferueshme dhe duhet të ushtrohet vetëm nga punonjësit të cilit i është dhënë kjo e drejtë. Pjeset e lëshuara pas blerjes të një opsioni mund t'u nënshtrohen kufizimeve të tilla siç janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë apo në këtë Marrëveshje.

c. Angazhime paraprake. Si kusht për blerjen e pjeseve në pajtim me kufizimet e një Opsioni, Punonjësi angazhohet nëçdo kohë të përfundojë çdo marrëveshje që kërkohet nga Ortaku apo Administratori i Shoqërisë për të përmbushur detyrimet e nevojshme ligjore apo fiskale që mund të lindin në lidhje me transaksionine shitblerjes së pjeseve.

d. Kufizime të të Drejtave. Asgjë në këtë marrëveshje nuk i jep Pjesëmarrësit ndonjë të drejtë për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit për një periudhë të caktuar apo ta ndërpresë atë sikundër nuk kufizon të drejtat e Shoqërisë të ndërpresë marrëdhëniet e punës të Pjesëmarrësit në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, me apo pa shkak.

e. Pjesëmarrësi nuk ka të drejtë t'i shesë, dhurojë, apo të transferojë në çdo mënyrë tjetër tek të tretët, apo t'i lerë peng apo ngarkojë me çfarëdo lloj barre, pjesërisht apo tërësisht pjesët që zotëron në kapitalin e Shoqërisë të fituara si pasojë e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

NENI 2
OPSIONET

a. **Opsionet**. Opsionet përfaqësojne një pjesë të kapitalit të Shoqërisë te shprehur në përqindje të kapitalit të shlyer të shoqërise dhe të cilat janë subjekt i Planit të Shites së Kuotave me Kusht të përcaktuar dhe evidentuara nga **"Njoftimi i Blerjes me Kusht"** të kësaj marrëveshjeje për të cilat Pjesëmarrësi gëzon të drejtën e blerjes më kusht. Këto Opsione do t'i nënshtrohen dhe do të jenë subjekt i kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshjeje.

b. **Masa e Kontibutit** (pjesë e kapitalit). Njoftimi i Blerjes me Kusht do të specifikojë masën e kontributit në përqindje të kapitalit që është subjekt i blerjes me kusht.

c. **Çmimi i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A specifikon çmimin e blerjes së Opsioneve i cili nuk mund të jetë më pak se njëqind për qind (100%) të vlerës së tregut të një kuote në përpjestim me kontributin përkatës të shprehur në përqindje të kapitalit në datën e nënshkrimit të marrëvëshjes. Çmimi i blerjes për çdo opsion të ofruar sipas këtij Plani do të përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga Ortaku Gjergji Guri sipas gjykimit të tij. Çmimi i ofruar duhet të jetë i pagueshem në një formë të përshkruar në Nenin 3.

d. **Kushtëzimi**. Opsionet do të kthehen në pjesë kapitali të bleshme (përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët (e), (f) dhe (g) më poshtë) në pjesë kumulative prej njëzet përqind (20%) te pjesës totale qe përfiton Pjesmarrësi, në fund të çdo viti të periudhës së kushtëzimit sic parashikohet në Shtojcën A.

e. **Blerja**. Opsionet duhet të blihen në datën e specifikuar në Njoftimin e Blerjes me Kusht; me kusht që, sidoqoftë, nëse një ngjarje anullimi ndodh para përfundimit të periudhës së kushtëzimit, e drejta për të ushtruar Opsionet anullohet dhe e drejta e

disponimit të opsionit i mbetet Ortakut i cili mund t'i disponojë ato sipas gjykimit dhe vullnetit të tij të lirë.

f. **Afati i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A, specifikon kufizimet në afate për blerjen e kuotave të ofruara në këtë plan që nuk mund të kalojë datën **30 Dhjetor 2023**, me përjashtim të rastit kur Ortaku përcakton një afat tjetër. Me përfundimin e Afatit të Blerjes, Pjesëmarrësi humbet të drejtën për të blerë opsionet e vlefshme të kapitalit të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërise.

g. **Ndërprerja e marrëdhenieve të punës**. Në rast se gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, Pjesëmarrësi largohet nga Shoqëria apo atij i ndërpritet kontrata e punës nga Punëdhënësi për cdo loj arsyeje, të gjitha Opsionet e akumuluara ndër vite por të pablera ende, do të anullohen menjëherë.

h. **Data e Blerjes**. Data e blerjes është data në të cilën Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes është dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku.

i. **Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes**. Eshtë njoftimi i dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku sipas parashikimeve të nenit 5.1, në të cilin duhet të caktohen të paktën:
   a. Masa e kontributit në kapital të Ortakut që do t'i ofrohen për shitje Pjesëmarrësit;
   b. Datën e Zbatimit.

j. **Data e Zbatimit**. Eshtë data e përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes për pagesën e çmimit për transferimin e pjesëve të shitura në këtë datë.

k. **Vendi i Zbatimit**. Eshtë në Tiranë, Shqipëri, siç përcaktohet në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes që do të jete vendi në të cilin Pjesëmarrësi do t'i paguajë Ortakut Çmimin e Shitjes së Pjesëve.

l. **E drejta e votës.** Deri në vërtetim të blerjes së pjesëve të ofruara kundrejt Çmimit të Blerjes, Pjesëmarrësi nuk gëzon të drejtën e votës si dhe asnjë të drejtë tjetër që mund të ushtrohet nga ortakët e shoqërisë në bazë të ligjit apo statutit të shoqërisë.

m. **Plotësimi i Kushtit të blerjes**: nënkupton përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

   a. Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes ushtruar nga Pjesmarrësi e nënshkruar rregullisht nga të dy palët dhe pasi jane plotësuar kushtet e parashikuara në këtë kontratë.
   b. Pagesa e cmimit të blerjes së përcaktuar nga Ortaku në, ose para datës së zbatimit sipas mënyrës së specifikuar ne këtë kontratë.

NENI 3
E DREJTA E BLERJES

a. Blerja e kuotave të lëshuara në bazë të kesaj marrëveshjeje do të paguhet me transfertë bankare duke kredituar llogarinë e Ortakut.

b. Nëse Pjesëmarrësi vendos të ushtrojë të Drejtën e Blerjes duke ushtruar Opsionin, blerja kushtëzohet vetëm mbi Pjesët që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërisë që janë objekt i kësaj marrëveshjeje sipas Çmimit të Blerjes së Pjeseve të Ortakut të përcaktuara në Noftimin e Blerjes me Kusht.

NENI 4
PËRCAKTIME

a) “Shoqëri” do të thotë shoqëria Facilization Shpk, e regjistruar sipas ligjeve Shqiptare, me seli në: " Rr . Barrikadave, P. 118, Ap . 15, 1001, Tiranë, Shqipëri, që vepron nën kodin NIPT : K94702003N.

b) "Ngjarje Anullimi" do të thotë (i) vdekja apo paaftësia, ose (ii) një ndryshim në kontrollin e Shoqërisë.

c) "Çmimi i Blerjes" do të thotë shuma për të cilën mund të blihet një pjese e kapitalit kur ushtohet Opsioni, siç është përcaktuar nga kjo marrëveshje në Njoftimin e Blerjes me Kusht nga Plani 2015.

d) “Vlera e Tregut " nënkupton vlerën e tregut të një pjese të kapitalit, siç përcaktohet nga Ortaku në mirëbesim. Përcaktim i tillë do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjithë punonjësit/pjesmarresit.

e) "Njoftimi i Blerjes me Kusht" do të thotë një njoftim në formën e bashkangjitur si Shtojca A e Marrëveshjes Për Blerjen me Kusht të Pjesëve të Kapitalit sipas Planit 2015 që evidenton dhënien e një mundësise për Punojësin nga Ortaku.

f) "Opsion" do të thotë alternativa për blerjen me kusht të nje pjese të kapitalit nën këtë kontratë qe i jep të drejtën mbajtësit për të blerë kuota kapitali të cilat janë subjekt i Planit të Shitjes së Kuotave me Kusht.

g) "Pjesëmarrës" nënkupton një punonjës të Shoqerisë të cilit Ortaku i ka ofruar, dhe që punonjësie ka pranuar, të drejtën për të blerë kuota sipas Planit 2015.

h) "Plan" do të thotë Plani i Shitjes së Kuotave me Kusht të Shoqërisë nga Ortaku.

i) “Kushtëzim Periudhe" do të thotë periudha katër (4) vjeçare duke filluar nga Data e Marrëveshjes gjatë të cilës Opsionet duhet të piqen duke u shndërruar në pjesë të barabarta prej njëzet përqind (20 %) në fund të çdo viti

NENI 5
ZBATIMI

5.1 Pjesëmarrësi ka të drejtë që, në çdo moment gjatë Afatit të Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, nëpërmjet dorëzimit të Njoftimit të Ushtrimit të së Drejtes së Blerjes Ortakut, të blejë pjesët e ofruara, kundrejt Çmimit të Blerjes. Me ushtrimin e kësaj të drejte nga ana e Pjesëmarrësit, ai do të jetë i detyruar të blejë Pjesët e ofruara kundrejt pagimit të Çmimit të Blerjes.

5.2 Shitja e Pjesëve do të perfshijë edhe të drejtën mbi çdo divident të deklaruar, por akoma të pa marrë nga Ortaku në lidhje me këto pjesë për përjudhën që fillon që nga data e kalimit të pronësisë tek Pjesmarrësi.

5.3 Pjesëmarrësi do të blejë në Datën dhe Vendin e Zbatimit Pjesët e Ortakut te përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, dhe do t’i paguajë Ortakut Çmimin e Blerjes në fonde menjëhere të përdorshme në monedhën e përcaktuar nga Ortaku.Ortaku do t’i dorëzojë Pjesëmarrësit dokumentet përkatëse të nënshkruara për transferimin e Pjesëve të lira nga çdo barrë.

NENI 6
DEKLARIME DHE GARANCI

6.1 Ortaku deklaron dhe garanton se Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar rregullisht dhe që ekziston sipas legjislacionit të Shqipërisë, është rregullisht e licencuar dhe zotëron leje dhe licenca të rregullta dhe në fuqi, të cilat

janë të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht. Ortaku gëzon zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe autoritet të plotë për të zotëruar dhe disponuar pronat e saj dhe të zhvillojë aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht.

6.2 Ortaku deklaron dhe garanton se gëzon zotësi të plotë juridike për të lidhur dhe zbatuar këte Marrëveshje dhe të transferojë pjesërisht apo tërësisht pjesët e kapitalit mbi të cilat Pjesëmarrësi mund të ushtrojë të Drejtën e Blerjes dhe këto pjesë janë të lira nga barra, kufizime apo të drejta të tjera të të tretëve mbi to.

NENI 7
TE NDRYSHME

7.1 Kjo Marrëveshje mund të shtohet apo ndryshohet vetëm nëpermjet një akti me shkrim dhe të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Pjesëmarrësi nuk mund t'i kalojë të tretëve, një pjesë apo të gjitha të drejtat që rrjedhin për të nga kjo Marrëveshje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ortakut.

7.3 Në rast se një ose disa nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të shfuqizohet, do të bëhet e pavlefshme apo e paekzekutueshme për shkak të parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj apo ligjeve që mund të hyjnë në fuqi gjatë kohëzgjatjes së saj, ajo klauzole do të veçohet dhe kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe ekzekutohet sikur klauzola e pavlefshme të mos ishte asnjëherë pjesë e Marrëveshjes dhe nenet e tjera të saj do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen aspak nga klauzola e pavlefshme, e shfuqizuar ose e paekzekutueshme ose nga veçimi i saj nga Marrëveshja.

7.4 Çdo njoftim apo komunikim sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet nëpërmjet (i) postës rekomande me pergjigje të marrësit në adresen e palës së cilës i behet njoftimi, (ii) postës ekspres, ose (iii) duke ia dorëzuar dorazi personit ose me postë elektronike (e-mail). Njoftimi do të konsiderohet i marrë në datën në të cilën është dorëzuar dorazi ose ditën e dytë të punës pas ditës së nisjes me postë ekspres. Nëse njoftimi dërgohet me poste rekomande, ai do të konsiderohet se është marrë diten e tretë të punës nga data në të cilën është postuar. Për qëllim njoftimi, adresat e palëve do të jenë ato që tregohen në fillimin e kësaj Marrëveshjeje.

7.5 Kjo Marrëveshje dhe të drejtat e detyrimet e palëve do të rregullohen, interpretohen dhe ekzekutohen në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet paraprakisht nga palët me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NE PRANI TE NJERI TJETRIT, palët nënshkruajnë këtë Marreveshje në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjte secila, sot më date 14/07/2016.

Nga:

Gjergji Guri

Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë Gjergji Guri

Nga:

Olti Ciriçi

Pjesëmarrësi
Emër Mbiemër Nënshkrim

**Shtojca A**

**NJOFTIMI I BLERJES ME KUSHT - Plani 2015**

**Emri i Blerësit:** Olti Qirici

**Pjesa e kapitalit:** 1,6% e kapitalit te Shoqërise Facilization Sh.p.k. i detajuar në Grafikun e Kushteve te Blerjes si më poshtë

**Çmimi i Blerjes:** 400,000 (Katërqind mijë) LEK

**Data e Marreveshjes:** 14 Korrik 2016

**Data e Blerjes:** E drejta e blerjes mund të zbatohet si e plotë apo në pjesë për perqindjen e kapitalit qe është pjesë e kësaj marrëveshjeje në përputhje me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje duke filluar nga data e nënshkrimit të Njoftimit të Blerjes me Kusht

**Grafiku i Kushteve të Blerjes:** Opsionet do të maturohen për të qenë kuota të bleshme të kapitalit në përputhje me kushtet dhe termat e përcaktuara në seksionin 2 (d) të Marrëveshjes sipas grafikut më poshtë:

| Data | Përqindje e vlefshme për Blerje |
|---|---|
| 14-07-2016 | 0,32 |
| 14-07-2017 | 0,64 |
| 14-07-2018 | 0,96 |
| 14-07-2019 | 1,28 |
| 14-07-2020 | 1,6 |
| 30-12-2023 | 1,6 |

**Data e Skadencës:** Në varësi të përfundimit të mëhershëm , në përputhje me nenin 2 (g) të Marrëveshjes, Opsioni dhe e drejta e blerjes së kuotave të kapitalit do të përfundojë më **30 Dhjetor 2023**.

**BLERESI/Pjesëmarrësi:** Olti Qirici

**Emër Mbiemër Nënshkrimi**

**Datë:** 14.07.2016

**SHITESI/ Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë:** Gazi Gazi

**Emër Mbiemër Nënshkrimi**

**Datë:** 14.07.2016



# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot, më **05-Nëntor-2018** është nënshkruar kjo Kontratë shitblerje kuotash (këtu e më poshtë referuar si "**Kontrata**") midis palëve të mëposhtme:

- Z. **Gjergji GURI**, i biri i Anestit, lindur më 9.6.1975 në Korçë dhe banues në Rr. Faik Konica, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisëFacilization SHPK,(më poshtë i quajtur " **Shitësi**");

*Dhe*

- Z. **Olti Qirici**, i biri i Pavllos, lindur më 25.06.1985 në Tiranë dhe banues në Rr. Ali Pashe Gucia, P.69/1, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I50625134L, Punëmarrësi shoqërisë Facilization SHPK,(më poshtë i quajtur "**Bleresi**");

Shitësi dhe Blerësi të cilët referohen bashkërisht si '**Palët**" dhe individualisht si "**Pala**".

NDERSA:

I. Në bazë të Vendimit të Ortakëve të shoqërisë **Facilization SHPK** me datë 14-dhjetor-2015, një shoqëri e themeluar dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Shqipëri më 2 Nëntor 2009, me seli në Rr. Sami Frashëri, P. 56, Kompleksi TID, Hyrja B, Kati 1, Tiranë, me numër unik të identifikimit të subjektit K94702003N me kapital të regjistruar prej 5.000.000,00 lekë, ortakët të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë **Facilization SHPK,** kanë vendosur të lejojnë ortakun Gjergji Guri i cili është zotërues i një kuote e cila përfaqësonte në atë moment 95% të kapitalit të Shoqërisë të ofrojë për shitje një pjesë të përqindjes që zotëron në kapitalin e shoqërisë në sasinë jo më shumë se 17% të kapitalit dhe kohën dhe mënyrën e caktuar prej ortakut Gjergji Guri nëpërmjet marrëveshjeve që ky i fundit do të nënshkruajë me blerësin/t potencial/ë sipas vullnetit dhe gjykimit të tij të lirë.

II. Bazuar në sa më sipër si dhe në bazë të Marrëveshjes së opsionit datë 14 Korrik 2016 të nënshkruar midis ortakut Gjergji Guri dhe Olti Qirici, ky i fundit ka dorëzuar më datë 26 tetor 2018 Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes sipas parashikimeve të Marrëveshjes së opsionit të cituar në këtë nen

**ATEHERE**, palët bien dakord sa më poshtë:

**Neni 1**
**Objekti**

1.1 Shitësi bie dakord t'i shesë Blerësit dhe Blerësi bie dakord të blejë nga Shitësi 1 (një) kuotë të zotëruar prej këtij të fundit në kapitalin e Shoqërisë, e cila përfaqëson 0.32% (zero pike tridhjetë e dy për qind) të kapitalit të Shoqërisë me vlere nominale 16,000 Leke (gjashtëmbëdhjetë mije leke), të lirë nga çdo peng ("**Kuota**").

**Neni 2**
**Çmimi i kuotës dhe mënyra e pagesës**

2.1 Çmimi që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për blerjen e Kuotës do të jetë 80.000,00 (tetëdhjetë mijë Leke) dhe do të paguhet sipas nenit 3 më poshtë.

**Neni 3**
**Transferimi i kuotës**

3.1 Të drejtat pronësisë të Shitësit mbi Kuotën e Shoqërisë do t'i transferohen Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën e çmimit prej 80.000,00 Leke (tetëdhjetë mijë Leke) në llogarinë bankare të Shitësit sipas të dhënave të mëposhtme:
Gjergji Guri, Banka Kombëtare Tregtare - DEGA PIAZZA, Numër Llogarie LEK : 402328893, IBAN: AL8720511320328893CLIDCLALLG

3.2. Transferimi i kuotës do të ndodhë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën shumesprej 80.000,00 (tetëdhjetë mijë Leke) tëçmimit të shitblerjes.

3.3 Pas transferimit të pjesës së mësipërme të kapitalit Blerësi do të zotërojë 1 (Një) kuotë e cila përbën 0.96% (zero pikë nëntëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale 48,000 dyzetë e tetë mijë lekë), ndërsa Shitësit i mbetet një kuotë e cila përfaqëson 88.78% ( tetëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e tetë përqind)

3.4 Palët janë në dijeni dhe bien shprehimisht dakord që Blerësi nuk ka të drejta dhe pretendime mbi fitimet e pa shpërndara te shoqërisë të cilat mund të shpërndahen si dividend i aplikueshëm mbi kuotën objekt i kësaj kontrate shitje, për vitin financiar i cili përfundoi më 31 dhjetor 2017 apo vitet e tjerë paraardhes. Blerësi fiton të drejtën mbi fitimet e shoqërisë të realizuara gjatë vitit aktual i cili përfundon në 31 dhjetor 2018, dhe gjithmonë në raport me kuotën që zotëron në shoqëri si dhe në proporcion me periudhën e fitimit të kësaj kuote.

**Neni 4**
**Përfaqësime dhe garanci**

4.1 Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Shitësi përfaqëson dhe i garanton Blerësit se:

i. Shitësi është zotëruesi i ligjshëm i 89.1% (tetëdhjetë e nëntë pikë një përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë së Kuotës, të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt material mbi të drejtën e pronësisë sëKuotës.

ii. Shitësi nuk po shkel ndonjë marrëveshje në të cilën paraqitet si palë, e cila mund të ndikojë negativisht në blerjen e Kuotës;

iii. Kuotanuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi apo barre në favor të ndonjë palë të tretë.

4.2 Shitësi përfaqëson dhe garanton se ka aftësinë ligjore të nënshkruajë këtëkontratë dhe të gjitha kushtet dhe afatet të kësaj kontratë janë të detyrueshme për tu zbatuar prej tij.

4.3 Asnjë konflikt/përputhshmëria me ligjin e aplikueshëm: Nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate, përfundimi i Mbylljes si dhe çdo dokument tjetër dhe transaksion i parashikuar këtu, nuk përbën konflikt me, nuk rezulton në shkelje me apo të përbëjë shkelje nën: a) çdo ligj, rregullore, gjykimi, urdhër, dekret, urdhër ose vendim i ndonjë gjykate, autoritet apo arbitrit në fuqi ose që kanë juridiksion mbi Shitësin; apo b) ndonjë shoqëri apo dispozitë kontraktuale me të cilin Shitësi është i detyruar as ndonjë marrëveshje tjetër ose instrument të cilin Shitësi është palë.

4.4. Shitësi ka të drejta të plota ligjore mbi pronësinë e Kuotës dhe ka të drejtën e plotë dhe kompetencën për të shitur, caktuar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

**Neni 5**
**Taksat e aplikueshme**

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhen sipas ligjit.

**Neni 6**
**Të ndryshme**

6.1 Kjo Kontratësë bashku me Marrëveshjen e opsionit datë 14-Korrik-2016 përbëjnë marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklarim, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis palëve që nuk është përfshirë në këtëKontratë dhe në Marrëveshjen e opsionit që mund tëkenë pasojë ose efekt mbi Kontratën ose objektin e saj.

6.2 Kjo Kontratë nuk do tëndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojëKontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i

detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të dyja palët.

6.3Nëse ndonjë nga nenet e Kontratësshpallete pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

6.4 Blerësi nuk do transferojë Kontratën dhe/ose të drejtat dhe detyrimet përkatëse sipas kësaj Kontrate, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit.

6.5 Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera midis palëve kontraktore do të bëhen në formë të shkruar dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen nëpërmjet postës së regjistruar ose elektronike në adresën e mëposhtme:

**Z. Gjergji Guri**

Posta: Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë
Posta Elektronike: gjguri@gmail.com

**Z. Olti Qirici**

Posta: Rr. Ali Pashe Gucia, P.69/1, Tiranë
Posta Elektronike: oltiqirici@yahoo.com

6.6 Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësishtë kundër njërës Palë në krahasim me Palën që ka përgatitur të njëjtën gjë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Kontrate.

6.7 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.8 Kontrata hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, një kopje për shitësin, një për blerësin dhe një për regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

| | |
|---|---|
| **Për shitësin** | **Për blerësin** |
| **Gjergji GURI** | **Olti Qirici** |

**MARREVESHJE PER BLERJEN ME KUSHT TE PJESEVE TE KAPITALIT-PLANI 2015**

---

MIDIS

Ortakut dhe Administratorit të Shoqërisë Facilization SHPK
**Gjergji Guri**

Dhe Punonjësit të Shoqërisë Facilization SHPK
**Ilsa Kasimati**

Datë, 14-Shtator-2016

---

# MARREVESHJE PER BLERJEN PJESEVE TE KAPITALIT

MIDIS:

- Z. Gjergji Guri, i biri i Anestit, lindur më 9/6/1975 në Korcë dhe banues në Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisë,(më poshtë i quajtur " **Ortaku**");

Dhe

- Znj. Ilsa Kasimati, e bija e Durimit, lindur më 18.07.1987 në Fier dhe banuese në Lagj. Ali Demi, Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me Nr. Personal I75718098K, Punonjëse e shoqërisë Facilization SHPK, (më poshtë e quajtur " **Pjesëmarrësi**");

Të gjithë palët e përmëndura më sipër, të gjithë së bashku do të quhen "Palët".

PLANI I SHITJEVE TE KUOTAVE ME KUSHT 2015

**Qëllimi**
Qëllimi i këtij Plani është që të promovojë objektivat e shoqërise Facilization shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria") duke ju ofruar punonjësve të dalluar stimuj për të maksimizuar vlerën e Shoqërisë dhe vazhdimësinë e punësimit në të. Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me gërma kapitale të përdorura në këtë dokument janë të përcaktuara në nenin 4.

**Administrimi**
Plani do të administrohet nga Gjergji Guri (më poshtë quajtur "Ortaku") që do të ketë autoritet të plotë dhe liri të pakushtëzuar për të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron të nevojshëm për administrimin dhe funksionimin e Planit.Ortaku nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, i jep Pjesëmarrësit të drejtën që të blejë prej tij pjese që ai zotëron në kapitalin e Shoqërise, sipas kushteve të parashikuara më poshtë.

**Kuotat e Vlefshme në Plan**

I. **Kuota Bazë**. Ortaku zotëronte me datë 30 Dhjetor 2015, 4.750 kuota të kapitalit, të Shoqërisë Facilization Shpk të cilat në bazë të Ligjit Nr. 129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, konvertohet në 1 kuotë, me vlerë 4.750.000,00 Lekë e cila perfaqëson 95% te kapitalit të regjistruar i cili ka vlerën 5.000.000 LEKE. Përqindja totale e kuotës në pronësi të tij që Ortaku vë në dispozicion të punojësve të Shoqërisë në favor të këtij Plani nuk duhet t'i tejkalojë shtatëmbëdhjetë përqind (17%) të kapitalit të Shoqërisë. Përqindja e kapitalit e vlefshme për blerje me kusht (Opsione) do u jepet punojësve të Shoqërisë që përmbushin kushtet e vëna nga Ortaku.

II. **Kuota Shtesë.** Në rastin e skadencës së Opsioneve të dhëna, anullimit ose kur një Opsion ka përfunduar, pjesët e vëna në dispozicion deri në atë moment, të cilat nuk janë blerë nga Pjesëmarrësi, do të kthehen përsëri në dispozicion për qëllimin e Planit.

**DUKE PATUR PARASYSH PLANIN E SIPERPERMENDUR, PALET BIEN DAKORT SI VIJON:**

NENI 1
PERKUFIZIME TE PERGJITHSHME

a. Termat e përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e përshkruar më poshtë nëse nuk është parashikuar ndryshe apo nëse nuk kanë kuptim tjetër sipas kontekstit të përdorimit.

b. Patransferueshmëria. Asnjë Opsion nuk mund të transferohet, ose premtohet nga Pjesëmarrësi te një i tretë gjatë jetës së tij. Në varësi të kufizimeve të përfshira në këtë nen, një opsion mund të blihet gjatë jetës së Pjesëmarrësit vetëm nga Pjesëmarrësi. Kjo e drejtë nuk do të jetë e transferueshme dhe duhet të ushtrohet vetëm nga punonjësit të cilit i është dhënë kjo e drejtë. Pjeset e lëshuara pas blerjes të një opsioni mund t'u nënshtrohen kufizimeve të tilla siç janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë apo në këtë Marrëveshje.

c. Angazhime paraprake. Si kusht për blerjen e pjeseve në pajtim me kufizimet e një Opsioni, Punonjësi angazhohet nëçdo kohë të përfundojë çdo marrëveshje që kërkohet nga Ortaku apo Administratori i Shoqërisë për të përmbushur detyrimet e nevojshme ligjore apo fiskale që mund të lindin në lidhje me transaksionine shitblerjes së pjeseve.

d. Kufizime të të Drejtave. Asgjë në këtë marrëveshje nuk i jep Pjesëmarrësit ndonjë të drejtë për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit për një periudhë të caktuar apo ta ndërpresë atë sikundër nuk kufizon të drejtat e Shoqërisë të ndërpresë marrëdhëniet e punës të Pjesëmarrësit në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, me apo pa shkak.

e. Pjesëmarrësi nuk ka të drejtë t'i shesë, dhurojë, apo të transferojë në çdo mënyrë tjetër tek të tretët, apo t'i lerë peng apo ngarkojë me çfarëdo lloj barre, pjesërisht apo tërësisht pjesët që zotëron në kapitalin e Shoqërisë të fituara si pasojë e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

NENI 2
OPSIONET

a. **Opsionet**. Opsionet përfaqësojne një pjesë të kapitalit të Shoqërisë te shprehur në përqindje të kapitalit të shlyer të shoqërise dhe të cilat janë subjekt i Planit të Shites së Kuotave me Kusht të përcaktuar dhe evidentuara nga "**Njoftimi i Blerjes me Kusht"** të kësaj marrëveshjeje për të cilat Pjesëmarrësi gëzon të drejtën e blerjes më kusht. Këto Opsione do t'i nënshtrohen dhe do të jenë subjekt i kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshjeje.

b. **Masa e Kontibutit** (pjesë e kapitalit). Njoftimi i Blerjes me Kusht do të specifikojë masën e kontributit në përqindje të kapitalit që është subjekt i blerjes me kusht.

c. **Çmimi i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A specifikon çmimin e blerjes së Opsioneve i cili nuk mund të jetë më pak se njëqind për qind (100%) të vlerës së tregut të një kuote në përpjestim me kontributin përkatës të shprehur në përqindje të kapitalit në datën e nënshkrimit të marrëvëshjes. Çmimi i blerjes për çdo opsion të ofruar sipas këtij Plani do të përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga Ortaku Gjergji Guri sipas gjykimit të tij. Çmimi i ofruar duhet të jetë i pagueshem në një formë të përshkruar në Nenin 3.

d. **Kushtëzimi**. Opsionet do të kthehen në pjesë kapitali të bleshme (përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët (e), (f) dhe (g) më poshtë) në pjesë kumulative prej njëzet përqind (20%) te pjesës totale qe përfiton Pjesmarrësi, në fund të çdo viti të periudhës së kushtëzimit sic parashikohet në Shtojcën A.

e. **Blerja**. Opsionet duhet të blihen në datën e specifikuar në Njoftimin e Blerjes me Kusht; me kusht që, sidoqoftë, nëse një ngjarje anullimi ndodh para përfundimit të periudhës së kushtëzimit, e drejta për të ushtruar Opsionet anullohet dhe e drejta e

disponimit të opsionit i mbetet Ortakut i cili mund t'i disponojë ato sipas gjykimit dhe vullnetit të tij të lirë.

f. **Afati i Blerjes**. Njoftimi i Blerjes me Kusht që nënshkruhet në Shtojcën A, specifikon kufizimet në afate për blerjen e kuotave të ofruara në këtë plan që nuk mund të kalojë datën **30 Dhjetor 2023**, me përjashtim të rastit kur Ortaku përcakton një afat tjetër. Me përfundimin e Afatit të Blerjes, Pjesëmarrësi humbet të drejtën për të blerë opsionet e vlefshme të kapitalit të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërise.

g. **Ndërprerja e marrëdhenieve të punës**. Në rast se gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, Pjesëmarrësi largohet nga Shoqëria apo atij i ndërpritet kontrata e punës nga Punëdhënësi për cdo loj arsyeje, të gjitha Opsionet e akumuluara ndër vite por të pablera ende, do të anullohen menjëherë.

h. **Data e Blerjes**. Data e blerjes është data në të cilën Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes është dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku.

i. **Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes**. Eshtë njoftimi i dorëzuar nga Pjesëmarrësi tek Ortaku sipas parashikimeve të nenit 5.1, në të cilin duhet të caktohen të paktën:
   a. Masa e kontributit në kapital të Ortakut që do t'i ofrohen për shitje Pjesëmarrësit;
   b. Datën e Zbatimit.

j. **Data e Zbatimit**. Eshtë data e përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes për pagesën e çmimit për transferimin e pjesëve të shitura në këtë datë.

k. **Vendi i Zbatimit**. Eshtë në Tiranë, Shqipëri, siç përcaktohet në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes që do të jete vendi në të cilin Pjesëmarrësi do t'i paguajë Ortakut Çmimin e Shitjes së Pjesëve.

l. **E drejta e votës.** Deri në vërtetim të blerjes së pjesëve të ofruara kundrejt Çmimit të Blerjes, Pjesëmarrësi nuk gëzon të drejtën e votës si dhe asnjë të drejtë tjetër që mund të ushtrohet nga ortakët e shoqërisë në bazë të ligjit apo statutit të shoqërisë.

m. **Plotësimi i Kushtit të blerjes**: nënkupton përmbushjen e kushteve të mëposhtme:
   a. Njoftimi i Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes ushtruar nga Pjesmarrësi e nënshkruar rregullisht nga të dy palët dhe pasi jane plotësuar kushtet e parashikuara në këtë kontratë.
   b. Pagesa e cmimit të blerjes së përcaktuar nga Ortaku në, ose para datës së zbatimit sipas mënyrës së specifikuar ne këtë kontratë.

NENI 3
E DREJTA E BLERJES

a. Blerja e kuotave të lëshuara në bazë të kesaj marrëveshjeje do të paguhet me transfertë bankare duke kredituar llogarinë e Ortakut.

b. Nëse Pjesëmarrësi vendos të ushtrojë të Drejtën e Blerjes duke ushtruar Opsionin, blerja kushtëzohet vetëm mbi Pjesët që Ortaku zotëron në kapitalin e Shoqërisë që janë objekt i kësaj marrëveshjeje sipas Çmimit të Blerjes së Pjeseve të Ortakut të përcaktuara në Noftimin e Blerjes me Kusht.

NENI 4
PËRCAKTIME

a) “Shoqëri” do të thotë shoqëria Facilization Shpk, e regjistruar sipas ligjeve Shqiptare, me seli në: “Rr. Sami Frashëri, P. 56, Kompleksi TID (qendra “Nobis”), Hyrja B, Kati 1 Tiranë, Shqipëri, që vepron nën kodin NIPT : K94702003N.

b) "Ngjarje Anullimi" do të thotë (i) vdekja apo paaftësia, ose (ii) një ndryshim në kontrollin e Shoqërisë.

c) "Çmimi i Blerjes" do të thotë shuma për të cilën mund të blihet një pjese e kapitalit kur ushtohet Opsioni, siç është përcaktuar nga kjo marrëveshje në Njoftimin e Blerjes me Kusht nga Plani 2015.

d) “Vlera e Tregut " nënkupton vlerën e tregut të një pjese të kapitalit, siç përcaktohet nga Ortaku në mirëbesim. Përcaktim i tillë do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjithë punonjësit/pjesmarresit.

e) "Njoftimi i Blerjes me Kusht" do të thotë një njoftim në formën e bashkangjitur si Shtojca A e Marrëveshjes Për Blerjen me Kusht të Pjesëve të Kapitalit sipas Planit 2015 që evidenton dhënien e një mundësise për Punojësin nga Ortaku.

f) "Opsion" do të thotë alternativa për blerjen me kusht të nje pjese të kapitalit nën këtë kontratë qe i jep të drejtën mbajtësit për të blerë kuota kapitali të cilat janë subjekt i Planit të Shitjes së Kuotave me Kusht.

g) "Pjesëmarrës" nënkupton një punonjës të Shoqerisë të cilit Ortaku i ka ofruar, dhe që punonjësie ka pranuar, të drejtën për të blerë kuota sipas Planit 2015.

h) "Plan" do të thotë Plani i Shitjes së Kuotave me Kusht të Shoqërisë nga Ortaku.

i) “Kushtëzim Periudhe" do të thotë periudha katër (4) vjeçare duke filluar nga Data e Marrëveshjes gjatë të cilës Opsionet duhet të piqen duke u shndërruar në pjesë të barabarta prej njëzet përqind (20 %) në fund të çdo viti

NENI 5
ZBATIMI

5.1 Pjesëmarrësi ka të drejtë që, në çdo moment gjatë Afatit të Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, nëpërmjet dorëzimit të Njoftimit të Ushtrimit të së Drejtes së Blerjes Ortakut, të blejë pjesët e ofruara, kundrejt Çmimit të Blerjes. Me ushtrimin e kësaj të drejte nga ana e Pjesëmarrësit, ai do të jetë i detyruar të blejë Pjesët e ofruara kundrejt pagimit të Çmimit të Blerjes.

5.2 Shitja e Pjesëve do të perfshijë edhe të drejtën mbi çdo divident të deklaruar, por akoma të pa marrë nga Ortaku në lidhje me këto pjesë për përjudhën që fillon që nga data e kalimit të pronësisë tek Pjesmarrësi.

5.3 Pjesëmarrësi do të blejë në Datën dhe Vendin e Zbatimit Pjesët e Ortakut te përcaktuar në Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes, dhe do t’i paguajë Ortakut Çmimin e Blerjes në fonde menjëhere të përdorshme në monedhën e përcaktuar nga Ortaku.Ortaku do t’i dorëzojë Pjesëmarrësit dokumentet përkatëse të nënshkruara për transferimin e Pjesëve të lira nga çdo barrë.

NENI 6
DEKLARIME DHE GARANCI

6.1 Ortaku deklaron dhe garanton se Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar rregullisht dhe që ekziston sipas legjislacionit të Shqipërisë, është rregullisht e licencuar dhe zotëron leje dhe licenca të rregullta dhe në fuqi, të cilat

janë të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht. Ortaku gëzon zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe autoritet të plotë për të zotëruar dhe disponuar pronat e saj dhe të zhvillojë aktivitetin ekonomik në mënyrën që po e zhvillon aktualisht.

6.2 Ortaku deklaron dhe garanton se gëzon zotësi të plotë juridike për të lidhur dhe zbatuar këte Marrëveshje dhe të transferojë pjesërisht apo tërësisht pjesët e kapitalit mbi të cilat Pjesëmarrësi mund të ushtrojë të Drejtën e Blerjes dhe këto pjesë janë të lira nga barra, kufizime apo të drejta të tjera të të tretëve mbi to.

NENI 7
TE NDRYSHME

7.1 Kjo Marrëveshje mund të shtohet apo ndryshohet vetëm nëpermjet një akti me shkrim dhe të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Pjesëmarrësi nuk mund t'i kalojë të tretëve, një pjesë apo të gjitha të drejtat që rrjedhin për të nga kjo Marrëveshje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ortakut.

7.3 Në rast se një ose disa nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të shfuqizohet, do të bëhet e pavlefshme apo e paekzekutueshme për shkak të parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj apo ligjeve që mund të hyjnë në fuqi gjatë kohëzgjatjes së saj, ajo klauzole do të veçohet dhe kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe ekzekutohet sikur klauzola e pavlefshme të mos ishte asnjëherë pjesë e Marrëveshjes dhe nenet e tjera të saj do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen aspak nga klauzola e pavlefshme, e shfuqizuar ose e paekzekutueshme ose nga veçimi i saj nga Marrëveshja.

7.4 Çdo njoftim apo komunikim sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet nëpërmjet (i) postës rekomande me pergjigje të marrësit në adresen e palës së cilës i behet njoftimi, (ii) postës ekspres, ose (iii) duke ia dorëzuar dorazi personit ose me postë elektronike (e-mail). Njoftimi do të konsiderohet i marrë në datën në të cilën është dorëzuar dorazi ose ditën e dytë të punës pas ditës së nisjes me postë ekspres. Nëse njoftimi dërgohet me poste rekomande, ai do të konsiderohet se është marrë diten e tretë të punës nga data në të cilën është postuar. Për qëllim njoftimi, adresat e palëve do të jenë ato që tregohen në fillimin e kësaj Marrëveshjeje.

7.5 Kjo Marrëveshje dhe të drejtat e detyrimet e palëve do të rregullohen, interpretohen dhe ekzekutohen në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet paraprakisht nga palët me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NE PRANI TE NJERI TJETRIT, palët nënshkruajnë këtë Marreveshje në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjte secila, sot më date 14/09/2016.

Nga:

____________________
Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë Gjergji Guri

Nga:

____________________
Pjesëmarrësi
Emër Mbiemër Nënshkrim

**Shtojca A**

**NJOFTIMI I BLERJES ME KUSHT - Plani 2015**

**Emri i Blerësit:** Ilsa Kasimati

**Pjesa e kapitalit:** 2% e kapitalit te Shoqërise Facilization Sh.p.k. i detajuar në Grafikun e Kushteve te Blerjes si më poshtë

**Çmimi i Blerjes:** 500,000 (Pesëqind mijë) LEK

**Data e Marreveshjes:** 14 Shtator 2016

**Data e Blerjes:** E drejta e blerjes mund të zbatohet si e plotë apo në pjesë për perqindjen e kapitalit qe është pjesë e kësaj marrëveshjeje në përputhje me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje duke filluar nga data e nënshkrimit të Njoftimit të Blerjes me Kusht

**Grafiku i Kushteve të Blerjes:** Opsionet do të maturohen për të qenë kuota të bleshme të kapitalit në përputhje me kushtet dhe termat e përcaktuara në seksionin 2 (d) të Marrëveshjes sipas grafikut më poshtë:

| Data | Përqindje e vlefshme për Blerje |
|---|---|
| **14-09-2016** | 0,4 |
| **14-09-2017** | 0,8 |
| **14-09-2018** | 1,2 |
| **14-09-2019** | 1,6 |
| **14-09-2020** | 2,0 |
| **30-12-2023** | 2,0 |

**Data e Skadencës:** Në varësi të përfundimit të mëhershëm , në përputhje me nenin 2 (g) të Marrëveshjes, Opsioni dhe e drejta e blerjes së kuotave të kapitalit do të përfundojë më **30 Dhjetor 2023**.

**BLERESI/Pjesëmarrësi:**

**Emër Mbiemër Nënshkrimi** Ilsa Kasimati

**Datë:** 14-9-2016

**SHITESI/ Ortaku dhe Administratori i Shoqërisë:**

**Emër Mbiemër Nënshkrimi** Gjergji Ceali

**Datë:** 14-9-2016

# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot, më **31-tetor-2018** është nënshkruar kjo Kontratë shitblerje kuotash (këtu e më poshtë referuar si "**Kontrata**") midis palëve të mëposhtme:

- Z. **Gjergji GURI**, i biri i Anestit, lindur më 9.6.1975 në Korçë dhe banues në Rr. Faik Konica, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H50609132D, Ortak dhe Administrator Ligjor i shoqërisë Facilization SHPK,(më poshtë i quajtur " **Shitësi**");

*Dhe*

- Znj. **Ilsa Kasimati**, e bija e Durimit, lindur më 18.07.1987 në Fier dhe banuese në Lagj. 15 Tetori Fier mbajtëse e kartës së identitetit me Nr. Personal I75718098K, Punonjëse e shoqërisë Facilization SHPK, (më poshtë e quajtur " **Blerësi**");

Shitësi dhe Blerësi të cilët referohen bashkërisht si '**Palët**" dhe individualisht si "**Pala**".

NDERSA:

I. Në bazë të Vendimit të Ortakëve të shoqërisë **Facilization SHPK** me date 14-dhjetor-2015, një shoqëri e themeluar dheregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Shqipëri më2 Nëntor 2009,me seli nëRr. Sami Frashëri, P. 56, Kompleksi TID, Hyrja B, Kati 1, Tiranë, me numër unik të identifikimit të subjektit K94702003N me kapital të regjistruar prej 5.000.000,00 lekë, ortakët të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë**Facilization SHPK**, kanë vendosur të lejojnë ortakun Gjergji Guri i cili është zotërues i një kuote e cila përfaqësonte në atë moment 95% të kapitalit të Shoqërisë të ofrojë për shitje një pjesë të përqindjes që zotëron në kapitalin e shoqërisë në sasinë jo më shumë se 17% të kapitalit dhe kohën dhe mënyrën e caktuar prej ortakut Gjergji Guri nëpërmjet marrëveshjeve që ky i fundit do të nënshkruajë me blerësin/t potencial/ë sipas vullnetit dhe gjykimit të tij të lirë.

II. Bazuar në sa më sipër si dhe në bazë të Marrëveshjes së opsionit datë14 Shtator 2016 të nënshkruar midis ortakut Gjergji Guri dhe Ilsa Kasimati, kjo e fundit ka dorëzuar më datë 26 tetor 2018"Njoftimin e Ushtrimit të së Drejtës së Blerjes" sipas parashikimeve të Marrëveshjes së opsionit të cituar në këtë nen

**ATEHERE**, palët bien dakord sa më poshtë:

**Neni 1**
**Objekti**

1.1 Shitësi bie dakord t'i shesë Blerësit dhe Blerësi bie dakord të blejë nga Shitësi 1 (një) kuotë të zotëruar prej këtij të fundit në kapitalin e Shoqërisë, e cila përfaqëson 0.4% (zero pikëkatër për qind) të kapitalit të Shoqërisë me vlere nominale 20,000 Leke (njëzet mijë leke), të lirë nga çdo peng ("**Kuota**").

**Neni 2**
**Çmimi i kuotës dhe mënyra e pagesës**

2.1 Çmimi që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për blerjen e Kuotës do të jetë 100.000,00 (njëqind mijë Leke)dhe do të paguhet sipas nenit 3 më poshtë.

**Neni 3**
**Transferimi i kuotës**

3.1 Të drejtat pronësisë të Shitësit mbi Kuotën e Shoqërisë do t'i transferohen Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën e çmimit prej çmimit prej 100.000,00 Leke (njëqind mijë Leke) në llogarinë bankare të Shitësit sipas të dhënave të mëposhtme:
Gjergji Guri, Banka Kombëtare Tregtare - DEGA PIAZZA, Numër Llogarie LEK : 402328893, IBAN: AL8720511320328893CLIDCLALLG

3.2. Transferimi i kuotës do të ndodhë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pagesën shumesprej 100.000,00 (njëqind mijë Leke) tëçmimit të shitblerjes.

3.3 Pas transferimit të pjesës së mësipërme të kapitalit Blerësi do të zotërojë 1 (Një) kote e cila përbën 1.2 % (një pikë dy përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale 60,000 (gjashtëdhjetë mijë lekë), ndërsa Shitësit i mbetet një kuote e cila përfaqëson 89.42% (tetëdhjetë e nëntë pike dyzetë e dy përqind)

3.4 Palët janë në dijeni dhe bien shprehimisht dakord që Blerësi nuk ka të drejta dhe pretendime mbi fitimet e pashpërndara tëshoqërisë të cilat mund të shpërndahen si dividend i aplikueshëm mbi kuotën objekt i kësaj kontrate shitje, për vitin financiar i cili përfundoi më 31 dhjetor 2017 apo vitet e tjerë paraardhes.Blerësi fiton të drejtën mbi fitimet e shoqërisë të realizuara gjatë vitit aktual i cili përfundon në 31 dhjetor 2018, dhe gjithmonë në raport me kuotën që zotëron në shoqëri si dhe në proporcion me periudhën e fitimit të kësaj kuote.

**Neni 4**
**Përfaqësime dhe garanci**

4.1 Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Shitësi përfaqëson dhe i garanton Blerësit se:

i. Shitësi është zotëruesi i ligjshëm i 89.82% (tetëdhjetë e nëntë pike tetëdhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë sëKuotës, të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt material mbi të drejtën e pronësisë sëKuotës.

ii. Shitësi nuk po shkel ndonjë marrëveshje në të cilën paraqitet si palë, e cila mund të ndikojë negativisht në blerjen e Kuotës;

iii. Kuotanuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi apo barre në favor të ndonjë palë të tretë.

4.2 Shitësi përfaqëson dhe garanton se ka aftësinë ligjore të nënshkruajë këtëkontratë dhe të gjitha kushtet dhe afatet të kësaj kontratë janë të detyrueshme për tu zbatuar prej tij.

4.3 Asnjë konflikt/përputhshmëria me ligjin e aplikueshëm: Nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate, përfundimi i Mbylljes si dhe çdo dokument tjetër dhe transaksion i parashikuar këtu, nuk përbën konflikt me, nuk rezulton në shkelje me apo të përbëjë shkelje nën: a) çdo ligj, rregullore, gjykimi, urdhër, dekret, urdhër ose vendim i ndonjë gjykate, autoritet apo arbitrit në fuqi ose që kanë juridiksion mbi Shitësin; apo b) ndonjë shoqëri apo dispozitë kontraktuale me të cilin Shitësi është i detyruar as ndonjë marrëveshje tjetër ose instrument të cilin Shitësi është palë.

4.4. Shitësi ka të drejta të plota ligjore mbi pronësinë e Kuotës dhe ka të drejtën e plotë dhe kompetencën për të shitur, caktuar, transferuar dhe dorëzuar Kuotën në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

**Neni 5**
**Taksat e aplikueshme**

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhen sipas ligjit.

**Neni 6**
**Të ndryshme**

6.1 Kjo Kontratësë bashku me Marrëveshjen e opsionit datë14-Shtator-2016përbëjnë marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklarim, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis palëve që nuk është përfshirë në këtëKontratë dhe në Marrëveshjen e opsionit që mund tëkenë pasojë ose efekt mbi Kontratën ose objektin e saj.

6.2 Kjo Kontratë nuk do tëndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojëKontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i

detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të dyja palët.

6.3Nëse ndonjë nga nenet e Kontratësshpallete pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

6.4 Blerësi nuk do transferojë Kontratën dhe/ose të drejtat dhe detyrimet përkatëse sipas kësaj Kontrate, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit.

6.5 Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera midis palëve kontrakturë do të bëhen në formë të shkruar dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen nëpërmjet postës së regjistruar ose elektronike në adresën e mëposhtme:

**Z. Gjergji Guri**

Posta: Rr. Faik Konica, Nd. 21, H.3, Ap. 44 Tiranë
Posta Elektronike: gjguri@gmail.com

**Z. Ilsa Kasimati**

Posta: Lagjja 15 Tetori Fier
Posta Elektronike: ilsa.kasimati@gmail.com

6.6Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësishtë kundër njërës Palë në krahasim me Palën që ka përgatitur të njëjtën gjë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Kontrate.

6.7 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.8Kontrata hartohet dhe nënshkruhet në3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, një kopje për shitësin, një për blerësin dhe një për regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

| | |
|---|---|
| **Për shitësin** | **Për blerësin** |
| **Gjergji GURI** | **Ilsa Kasimati** |